

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Kandidati: Artan Millaku

Mentori: Prof.Dr.Azem Hajdari

Tema: Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në vështrim të vendimmarrjes në Gjykatën Supreme të Kosovës gjatë periudhës 2017-2021.

Abstrakti

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqet një mjet të jashtëzakonshëm juridik me rëndësi të veçantë, që ndërlidhet me situatën në të cilën paraqitet ajo, subjektin që e parashtron atë, kushtet që duhen plotësuar për ushtrimin e saj si dhe pasojat dhe efektet juridike që dalin nga ajo. Qëllimi i punimit është zgjerimi i njohurive lidhur me mjetet juridike, e veçanërisht lidhur me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik. Si gjykatë kompetente për të vendosur për mjetet e jashtëzakonshme juridike është Gjykata Supreme e Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës, nënkupton organin, apo autoritetin më të lartë gjyqësor në Kosovë, i cili ka juridiksion territorial në tërësinë e Republikës së Kosovës. Kodi i procedurës penale i Kosovës, ka përcaktuar personat e autorizuar për mundësinë ushtrimit të këtij mjeti juridik si dhe afatin brenda të cilit mund ta e ushtrojnë. Në këtë punim është bërë edhe krahasimi i këtij mjeti juridik me legjislacionet e shteteve të Republikës së Shqipërisë, Kroacisë dhe të Italisë, me ç’rast vënë në dukje pikat e përbashkëta dhe dallimet që i kanë këto kode ndërmjet veti. Në këtë punim po ashtu është paraqitur edhe numri i kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruara në Gjykatën Supreme të Kosovës gjatë periudhës 2017-2021, veprat penale për të cilat janë ushtruar si dhe mënyrën e vendimmarrjes nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Fjalët kyçe: Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës, Kodi i procedurës penale.